



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

Prishtinë, 20 Shkurt 2015

E nderuara familje Pllana,

Me dhimbje e mora lajmin për ndarjen nga jeta të akademik Ruzhdi Pllanës, kontribuues i jashtëzakonshëm për arsimimin e brezave të tërë të nxënësve dhe të studentëve të Universitetit të Prishtinës.

E nderuara familje Pllana, e ndaj me ju pikëllimin për humbjen e njeriut më të dashur, duke e kujtuar kontributin a pamohueshëm të akademik Ruzhdi Pllanës për arsimin dhe shkencën në Kosovë jo vetëm si pedagog i palodhshëm, por edhe si autor i teksteve shkollore dhe punimeve shkencore.

Vdekja e tij është humbje e madhe për familjen, për miqtë dhe për të gjithë ata që patën fatin të punojnë me akademikun e nderuar Pllana.

Në emër të qytetarëve të Republikës së Kosovës, në emër të Institucioneve dhe në emrin tim personal, ju lutem pranoni ngushëllimet më të sinqerta.

Me respekt,

Atifete Jahjaga
Presidente e Republikës së Kosovës